

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi për ish-krerët e UÇK, Gucati nga Haga: Besoj se verdikti do të jetë në anën tonë, akuzat nuk kanë fakte
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/vendimi-per-ish-kreret-e-uk-gucati-nga-haga-besoj-se-verdikti-do-te-jete--i104371
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 08:05:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 08:00:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ba1c4ab986ae64b17808d4f03b84bd53fe17f07ef3ca60fa29aa16be4f8bc1ed
TEKSTI	41a877eac61667994ccf1f064dc6a7c8fe6068cc9c481fb844d3b1879061f92d
PAMJA	bd0f7d28b7f94b3767c8e285fbdfa8632db66a5aec646d13b22b70630bd1ecae

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f946700258921f4bdcd2925f54c7652ab319dd6d451aaafca2b8dd1d826e3055
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a66b9440a0861df2d438551387cc4c0076e19988df5fe9b1c9268bd2c93d904
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/f946700258921f4bdcd2925f54c7652ab319dd6d451aaafca2b8dd1d826e3055

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)




Flash: amerikane në Arabinë se tij me Shtetet e Bashkuara, Anshmeria politike të mos ketë konsideron ndikim të anshmerisë per Edi Ramën përshkallëzuar nga burgu, Beci: paligjshëm mbremjen e djeshme në D...

KOSOVA

Vendimi për ish-krerët e UÇK, Gucati nga Haga: Besoj se verdikti do të jetë në anën tonë, akuzat nuk kanë fakte

Piranjat Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 10:00



Ish-kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, ka shprehur optimizmin e tij pak orë para shpalljes së aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë.

Në një prononcim për RTK nga Haga, ku ka udhëtuar për të ndjekur nga afër seancën, Gucati tha se pret një vendim pozitiv për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Sipas tij, akuzat ndaj ish-krerëve të UÇK-së nuk janë mbështetur në fakte dhe argumente.

"Pritjet e mia janë të mëdha, besoj se sot do të gëzohemi të gjithë me këtë qytetarë edhe me juve që jeni këtu. Besoj se verdikti do të jetë në anën tonë, duke pasur parasysh që s'kanë pasur fakte e argumente", deklaroi Gucati.

Ai kritikoi gjithashtu punën e Dhomave të Specializuara, duke pretenduar se në proces janë përdorur materiale të siguruar nga Serbia dhe Rusia. Gucati tha se shpreson që prania e madhe e shqiptarëve nga Kosova në Hagë dhe mbështetja e tyre të merren në konsideratë.

"Nëse s'është gjykatë politike, veç nëse është gjykatë që do drejtësi, duhet ta dëgjojë zërin e qytetarëve, zërin e një kombi", u shpreh ai.

Gucati shtoi se populli shqiptar ka treguar mbështetje për ish-krerët e UÇK-së dhe kërkoi që vendimi të mos ketë prapavijë politike.

"Unë besoj se kjo gjykatë duhet të jetë e drejtë, jo politike", tha ai.

Ish-kreu i veteranëve konfirmoi se do të jetë i pranishëm në sallën e gjyqit për të ndjekur drejtpërdrejt shpalljen e aktgjykimit.

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 16 Shtator09:52

Kongresmeni amerikan para vendimit për ish-krerët e UÇK: Anshmëria politike të mos ketë vend në Hagë

Kongresisti amerikan, Keith Self, shprehu shqetësim për atë që ai e konsideron ndikim të anshmërisë politike në vendim...

KOSOVA 16 Shtator09:36

Adriatik Lapaj nga Haga: Ditë historike, uroj që çlirimtarët të kthehen faqebardhë

Kreu i Lëvizjes Shqipëria Bëhet, Adriatik Lapaj, ka udhëtuar drejt Hagës, ku sot pritet të shpallet vendimi për ish-krerë...

KOSOVA 16 Shtator09:30

Frikë për përshkallëzim? Qeveria e Kosovës merr masa, rrethohet me gardh metalik. Policia në gatishmëri

Më pak se një orë para nisjes së seancës gjyqësore në Hagë, ku pritet të shpallet vendimi për ish-krerë...

KOSOVA 16 Shtator09:23

Konjufca: Presim vetëm një vendim, Aktgjykim lirues

"Presim vetëm një vendim, Aktgjykim lirues." Kështu tha shkurt Ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Glauk Konjufca mëng...

KOSOVA 16 Shtator09:02

Në pritje të vendimit në Hagë, familjarët e Hashim Thaçit dhe Rexhep Selimit hyjnë në gjykatë

Familjarët e Hashim Thaçit dhe Rexhep Selimit kanë hyrë në ambientet e Dhomave të Specializuara të Kosovës në H...

KOSOVA 16 Shtator08:56

'Jam gati 100% i bindur' - Dita e verdiktit për Thaçin, Veselin, Selimin dhe Krasniqin/ Walker: Procesi në Hagë është më shumë politik sesa drejtësi

Ish-ambasadori, William Walker, ka kritikuar procesin gjyqësor në Dhomat e Specializuara në Hagë, duke e cilësuar atë si një...

KOSOVA 16 Shtator08:41

Sot jepet dënimi për ish-krerët e UÇK-së/ Avokati i Thaçit: Do të flas pas vendimit

Pak para shpalljes së aktgjykimit ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë, avokati i Hashim ...

KOSOVA 16 Shtator08:32

Pak para vendimit në Hagë, mbështetësve të Thaçit dhe ish-krerëve të UÇK-së u kërkohet të largohen nga hapësirat para gjykatës

Mbështetësve të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të mbledhur para objektit të Dhomave të...

KOSOVA 16 Shtator08:10

Seanca për ish-krerët e UÇK-së/ Mbesa e Jakup Krasniqit puth portretin e gjyshit: Nuk jam e lirë pa lirinë tënde, të pres me mall

Ditën e sotme në orën 10:00 do të nisë seanca e fundit gjyqësore ndaj ish-krerëve të UÇK-së, ku do të...

KOSOVA 16 Shtator07:53

Hagë/ Sytë nga Gjykata Speciale, sot vendoset fati i Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit

Ka nisur numërimi mbrapsht në Hagë, ku kanë mbetur vetëm pak orë deri në shpalljen e vendimit për ish-krerët e Us...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

Takimi pikant zgjat shumë dhe përfundon si mos ...

Një takim seksual tepër i gjatë, një vjedhje parash, një debat midis një eskorte dhe klientit të saj, dhe në fund një...

AKTUALITET 15 Shtator

Rrëfihet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më...

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashkë...

AKTUALITET 15 Shtator

[Gjykata e Lartë merr vendimin për kreun e Bashk...](#)


Gjykata e Lartë shqyrtoi sot rigjykimin e çështjes që lidhet me masën e sigurisë ndaj kryebashkiakut të Tiranës, Eri...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video




Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV





Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.